

KONTRATE
SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 24.10.2022 (dymijë e njëzet e dy),

Adnand Mahmuti, i biri i Gëzim-it dhe i Fiqirete-s, i lindur në Tiranë më 06.05.1973, i identifikuar me kartën e identitetit me numër personal H30506164U, në cilësinë e ortakut të shoqërisë TIBO Sh.P.K. sipas ekstraktit bashkëlidhur kësaj kontrate, i cilësuar këtu e në vijim si “**Shitesi**”;

Mirgen Zaçellari, i biri i Gurali-ut dhe i Skenderije-s, lindur në Përg, Korçë, lindur më 15.09.1982 dhe banues në Tiranë me zotësi të plotë juridike për të vepruar i identifikuar me kartën e identitetit me numër personal I20915052C; i cilësuar këtu e në vijim si “**Blerësi**”.

Të cilësuarat vecmas dhe bashkërisht si “**Palët**”.

Duke qënë se

Shitesi Adnand Mahmuti zotëron kuota të shoqërisë TIBO sh.p.k me NUIS: L31708013Q që përfaqsojnë 42% (dyzet e dy pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Shitësit dëshirojnë të përfshijë në aktivitetin e shoqërisë Blerësin me objektivin e përmirësimit të aktivitetit tregtar të saj, rritjen dhe zgjerimin e bazës së tregut në të cilin operon dhe thithjen e kapitaleve financiare nga palë të treta, qofshin këto subjekte financiare bankare ose subjekte financiare jo banka;

Me qëllim sjelljen e ideve të reja dhe një fryme të re kontrolli mbi administrimin dhe veprimtarinë tregtare të shoqërisë;


Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë palët vendosin të redaktojnë dhe nënshkruajnë kontratën si më poshtë vijon:

Neni 1
Qëllimi dhe objekti kontratës

1. Qëllimi i kontratës është kalimi i pronësisë së sendeve të luajtshme të patrupëzuara, të cilat zotërohen në mënyrë të plotë dhe të pacënuar, nga Shitesi tek Blerësi.
2. Objekti i kontratës është kalimi i pronësisë së 1 kuote, të barabartë me 10% (dhjetë pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërisë TIBO sh.p.k me NUIS: L31708013Q e cila zotërohet nga ortaku **Adnand Mahmuti** në favor të **Mirgen Zaçellari** në cilësinë e blerësit.
3. Pronësia e shitësit mbi kuotën objekt kontrate vërtetohet nga Ekstrakti i thjeshtë i shoqërisë TIBO Sh.P.K. i të njëjtës datë me datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pjesë përbërëse dhe e pandashme e saj.

Neni 2
Çmimi dhe pagesa

1. Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së objektit të kontratës, sipas përcaktimeve të pikes 2 të nenit 1 të saj të jetë i barabartë me 500.000 (pesëqind mijë) Lekë.



2. Shuma që përbën cmimin e përcaktuar për kalimin e pronësisë së kuotës do të derdhet në llogarinë e Shitësit sipas ekstremiteteve bankare bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e kësaj kontrate jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

Neni 3

Pronësia dhe transferimi i kuotave

1. Shitësi garanton Blerësin se kuotat janë të lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj të treta dhe për çdo pretendim që mund të ngrenë të tretët Shitësi është i gatshëm dhe i detyruar të paraqitet me kërkesën e Blerësit para të gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.
2. Blerësi përjashtohet nga çdo detyrim administrative financiar apo ligjor ndaj vetë shoqërisë në cilësinë e ortakut, apo ndaj të treta, për detyrime që rrjedhin nga aktiviteti tregtar i shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Shitësi deklaron se të gjitha detyrimet e mëparshme të shoqërisë ndaj të treta do të përballohen nga kuota e zotëruar prej tij, dhe të drejtat që rrjedhin prej saj, në shoqëri.
3. Pala shitëse merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga cilësia e ortakut të palës blerëse deri në regjistrimin e kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

1. Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate ose pas përfundimit të saj por që rrjedhin nga kjo kontratë, do zgjidhen me arbitrazh. Institucioni i arbitrazhit do të jetë Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit. Rregullat e arbitrazhit do të jenë rregullat procedurale të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit. Mosmarrveshjet do të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, i cili do të caktohet nga Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit, sipas procedurave të këtij institucioni për caktimin e arbitrit të vetëm. Legjislacioni që do të zbatohet gjatë gjykimit në arbitrazh do të jetë legjislacioni shqiptar.

Sa parashikuar në dispozitat kontraktuese të mësipërme, në përputhje me nenin 686 të Kodit Civil Shqiptar, palët deklarojnë se pranojnë dhe miratojnë veçmas Nenet 2, 3 dhe 4 të saj.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi, zhvishet nga pronësia e 1 (një) koute me përqindje 10% (dhjetë pikë përqindje) të kapitalit themeltar dhe Blerësi bëhet zotëruar i 1 (një) koute me përqindje 10% (dhjetë pikë përqindje) të kapitalit themeltar.

SHITËSI

Adnand Mahmuti

Jep pëlqimin bashkëshortja

Albana Mahmuti me NID: I25809050J



BLERËSI

Mirgen Zaçellari

